

**C.nr. 1675/20**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM- DIVIZONI CIVIL**

---

**RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS (RTK)**

*Paditësja*

Me adresë në Rr. “Xhemajl Prishtina”, nr:12, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, i përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së z.Ngadhniym Kastrati.

Vs

**AGRON DEMI**

*I Padituri*

Me vendbanim në rrugën Kosta Novakovic C-51, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Sejdiu & Qerkini” sh.p.k., me seli në Lagjja Veternik, Kompleksi EXDC 3, Blloku 10, Kati 6, Nr:18, Prishtinë, Republika e Kosovës, përkatësisht nga avokatët Korab R.Sejdiu, Artan Qerkini, Miranda Haxhiu dhe juristët Taulant Hajdari, Burim Azemi, Blinera Osmani, dhe Kaltrina Kodraliu. <sup>1</sup>

**Provë 1: Autorizimi për përfaqësim**

---

**PËRGJIGJIE NË PADI**

---

Përgjigja në padi e hartuar dhe e paraqitur me respekt:  
Shoqëria e Avokatëve “*Sejdiu & Qerkini*” sh.p.k.  
Lagjja Veternik, Kompleksi EXDC 3,  
Blloku 10, Kati 6, Nr:18,  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
E-mail: [info@sq-law.com](mailto:info@sq-law.com)  
Tel.: +383 (0) 45 40 77 40

---

<sup>1</sup> Autorizimi për përfaqësim i z.Agron Demi, për Shoqërinë e Avokatëve “Sejdiu&Qerkini”.

## I. HYRJE

Radiotelevizioni i Kosovës –RTK (tani e tutje paditësja) përmes z. Ngadhnjim Kastrati- Drejtor i Përgjithshëm i RTK-së, ka ushtruar padi ndaj të paditurit Agron Demi (tani e tutje i padituri), duke pretenduar se si rezultat i shpifjes dhe fyerjes nga i padituri, paditësja ka pësuar dëm në reputacion, rënie të të hyrave financiare, zvarritje të aprovimit të Ligjit për Transmetuesin Publik dhe se ka nxitur urrejtje dhe dhunë ndaj paditëses.

Paditësja me padi ka kërkuar që të vërtetohet se i padituri ka bërë shpifje dhe fyerje në rrjetin e tij social në Facebook dhe ka kërkuar që i padituri të kërkojë falje publike ashtu që t'i tërheqë deklaratat të cilat kanë pretenduar se janë shpifëse dhe fyerëse ndaj paditëses. Poashtu përmes padisë ka kërkuar që të obligohet i padituri ti ndal shpifjet dhe fyerjet, dhe të premtojë se shpifja dhe fyerja nuk do të përsëritet në të ardhmen.

Padia e ushtruar nga paditësja hynë në kategorinë e Padive Strategjike Kundër Pjesëmarrjes së Publikut (SLAPP), qëllim i të cilave është zvarritja nëpër procese gjyqësore të zërave kritik ndaj fenomeneve negative në institucionet publike. Kundër kësaj padie kanë reaguar mbi 50 organizata vendore dhe ndërkombëtare, duke e cilësuar padinë e paditëses si tendencë për të zvarritur nëpër gjykata aktivistët dhe avokuesit për qeverisje të mirë.

### **Provë 2: Reagim i Lëvizjes FOL i datës 22.10.2021, për tërheqje të padisë ndaj aktivistit Agron Demi**

Si rrjedhojë konsiderojmë se kërkesëpadia e Paditësit nuk është e kuptueshme dhe e arsyeshme, sikurse përcaktohet me nenin 99 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (më tutje referuar si “LPK”) . Paditësit, në Kërkesëpadinë e tyre duhet të theksojnë objektin e kontestit dhe të ofrojnë përmbajtjen e deklaratës e cila duhet përveç tjerash të theksojë faktet mbi të cilat e bazon kërkesën si dhe provat me të cilat vërtetohen ato, sikurse kërkohet me nenin 99, paragrafi 2 dhe 3 të LPK-së. Nga kërkesëpadia e Paditëses nuk është e qartë së në bazë të cilave fakte Paditësit bazojnë kërkesën e tyre.

I padituri konteston në tërësi kërkesë-padinë e paditësit si të pabazuar dhe konsideron se e njëjta ka qëllim të keq për të dëmtuar dhe për të heshtur të Paditurin.

## **II. GJENDJA FAKTIKE**

Paditësja, me padi ka pretenduar se I padituri me deklaratimet e tij në rrjetin social Facebook të datave 13.03.2020, 14.03.2020, 04.04.2020 dhe 05.04.2020, ka bërë shpifje dhe fyerje, dhe si pasojë e këtyre deklaratave, është dëmtuar reputacioni i paditëses.

Tutje në padi paditësja pretendon se me këto deklarata paditëses i ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm në formën e cenimit të rëndë të reputacionit publik dhe nxitjes së dhunës ndaj paditëses. Paditësi tutje ka pretenduar se kinse i padituri ka përhapur urrejtje me fjalor nxitës tek publiku.

I Padituri në cilësinë e analistit të politikave dhe si pjesë e një organizate jo qeveritare, në vazhdimësi, që nga viti 2011, përmes raporteve të politikave, përmes shkrimeve në media tradicionale dhe përmes qëndrimeve në mediat sociale, ka avokuar për qëndrueshmërinë financiare të paditëses, pavarësinë editoriale dhe llogaridhënien financiare.

I padituri është analist politikash në organizatën joqeveritare GAP që nga viti 2008 dhe ka shërbyer si drejtor ekzekutiv i kësaj organizatë joqeveritare për rreth 6(gjashtë) vite. Instituti GAP synon që të mbushë hendekun në mes të qeverisjes dhe qytetarëve, në mes të problemeve dhe zgjidhjeve, me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare.

Puna e institutit lidhet ngushtë me avokimin për një qeverisje më të mirë, duke monitoruar punën e institucioneve publike, dhe duke rekomanduar zgjidhje konkrete mbi politikat publike. GAP adreson sfidat ekonomike, politike dhe sociale në vend duke mobilizuar profesionistë të fushave të ndryshme.

I padituri, ka shprehur opinionin e tij publik, në lidhje me ngjarjet e vazhdueshme tek paditësja, pa qëllim të fyerjes apo shpifjes. Puna e të paditurit lidhet ngushtë me kritikën ndaj institucioneve publike dhe mbikëqyrja e proceseve me interes publik.

### III. BAZA LIGJORE PËR REFUZIMIN E KËRKESËPADISË SË PADITËSES

Edhe pse në padi paditësja nuk e përcakton objektin e kontestit dhe vlerën e kontestit, paditësi padinë e mbështetë në nenin 4 dhe nenin 14 të Ligjit nr.02/L-65 Kundër Shpifjes dhe Fyerjes ( tutje referuar si LKSHF). Neni 4 i referohet veprimit kundër shpifjes dhe fyerjes ndërsa Neni 14 Kompensimit Për Shpifje.

Paditësja është autoritet publik, i themeluar me Ligjin nr.04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës. Me nenin 3.1 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës përcaktohet: 3.1. Radiotelevizioni i Kosovës (në tekstin e mëtejme RTK) është transmetues publik i Kosovës. Si e tillë, paditësja është e financuar direkt nga taksapaguesit, pra qytetarët e Republikës së Kosovës, përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Bazuar në nenin 5, paragrafi 4, të LKSHF, “Autoritetet publike ndalohen nga paraqitja e kërkesës për kompensim për dëmin e shkaktuar nga shpifja ose fyerja. Zyrtarët publik mund të paraqesin kërkesë për kompensim e dëmit nga shpifja apo fyerja privatisht dhe ekskluzivisht në kapacitetin e tyre personal.” Andaj, paditësja, si autoritet publik, i themeluar me Ligjin nr.04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, si dhe i financuar nga taksapaguesit përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës, nuk ka të drejtë të ushtroj këtë padi.

Në anën tjetër, angazhim i të Paditurit garantohet me Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 40, sipas të cilit “Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush.”

Liria e Shprehjes është e mbrojtur me nenin 10 të KEDNJ-së e cila thekson se:

- (1) Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t’u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë.
- (2) Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për

mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të drejtave të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

Në interpretimin e nenit 10 të KEDNJ-së dhe konfliktit permanent që ekziston mes lirisë së shprehjes në njërin anë dhe të drejtës në privatësi dhe reputacion të personave privat dhe figurave publike që mbrohet me nenin 8 të KEDNJ-së në anën tjetër, GJEDNJ ka zhvilluar një praktikë të gjerë sipas të cilës kërkesëpadia e Paditësve do të duhet të refuzohet si e pabazuar. GJEDNJ në rastin *Handyside kundër Britanisë së Madhe* (1976), vendim ky që është bazë e jurisprudencës së GJEDNJ-së, thekson se liria e shprehjes përbën një prej themeleve esenciale të një shoqërie demokratike dhe një prej kushteve bazike për progresin e saj.

Poashtu, neni 7 i LKSHF përcakton:

“Publikimet e arsyeshme- Askush nuk do të jetë përgjegjës për shpifje dhe fyerje për një deklaratë të një çështjeje me interes publik, nëse ata dëshmojnë se ishte e arsyeshme në të gjitha rrethanat për një person në pozitën e tyre të përhapte materialin me qëllim të mire, duke marrë parasysh rëndësinë e lirisë së shprehjes në lidhje me çështje të interesit publik që ai të marrë në kohë informacion për çështje të tilla.”

Ndërsa, Neni 8 i LKSHF përcakton: *Opinionet*- “Askush nuk do të jetë përgjegjës për shpifje dhe fyerje për një deklaratë të cilën gjykata e ka vlerësuar të jetë një deklaram i opinionit, me kusht që opinionin të jetë shprehur me qëllim të mirë dhe të jetë bazuar në ndonjë fakt”.

Në rastin konkret, I padituri si qytetarë i Republikës së Kosovës, tatimpagues i rregullt, aktivist për një kohë të gjatë në organizatë qeveritare, si pjesë aktive e shoqërisë civile ka shprehur pakënaqësitë e tij dhe ka shprehur opinionin përmes rrjetit të tij personal social. Në rastin në fjalë nuk është bërë as shpifje dhe as fyerje siç paditësja pretendon, dhe as nuk është pretenduar të bëhet.

#### IV. PRETENDIMET PËR SHPIFJE DHE FYERJE

Ligji nr.02/L-65 Kundër Shpifjes dhe Fyerjes në nenin 3 përcakton përkufizimet:

- a) Shpifja nënkupton publikimin e një fakti ose deklarate të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër.
- b) Fyerja nënkupton deklarimin, sjelljen, publikimin e deklaratës të drejtuar ndaj një personi tjetër e cila është nënçmuese.

Paditësja pretendon se i padituri ka shpifur dhe fyer në statusin e datës 13.03.2020, ku ndër të tjera i padituri ka kërkuar edhe mbylljen e menjëhershme të paditëses.

Reagimi i të paditurit ka ardhur pas kronikës së paditëses në emisionin “Speciale” të datës 13.03.2020, gjatë ditëve kur konfirmohen rastet e para me Covid-19.

Në këtë emision, profesionistë shëndetësorë, të ftuar në emisionin e lartcekur, përhapin panik sa i përket gatishmërisë për tu përballë me virusin.

**PROVË 3 : RTK. Speciale – Koronavirusi në Kosovë – Analizë 13.03.2020, kronikë, nga minuta 7 (Burimi: <https://www.youtube.com/watch?v=1WPvNKCOG7M>)**

Një ditë më pas, më 14.03.2020, i padituri ka reaguar edhe një herë në media sociale, pasi që njëra nga sindikatat e punëtorëve të paditëses, ka reaguar në postimin e të paditurit.

Në reagimin e të paditurit të po kësaj date, i padituri ka kërkuar që të mbyllet mediumi dhe të dënohen të gjithë ata që janë përgjegjës për punësime jo meritore dhe për faktin se paditësja nuk i nënshtrohet asnjë kontrolli financiar dhe llogaridhënie. Si taksapagues në shtetin e Kosovës dhe për faktin se paditësja merr 11 milionë e 200 mijë euro në vit nga Buxheti i Kosovës, i padituri ka parë të arsyeshme se është obligim qytetar dhe moral të kërkoj përgjegjësi për paratë e taksapaguesve. Se paditësja është institucion me parregullsi të shumta, e tregon edhe vetë Drejtori i Përgjithshëm, z. Ngadhnjim Kastrati, i cili në paraqitjen e tij para Kuvendit të Kosovës e pranon se për vite me radhë janë vjedhur qindra mijëra euro nga punonjës të paditëses.

**PROVË 4: Video-paraqitja e Ngadhnjim Kastrati para Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Financa, 7 tetor 2021 (Burimi: [https://www.youtube.com/watch?v=wLYfoS2z\\_M](https://www.youtube.com/watch?v=wLYfoS2z_M))**

Paditësja poashtu në padi ka përmendur edhe postimet e të paditurit, të datave 4 dhe 5 prill 2020, ku ndër të tjera i padituri ka pretenduar se paditësja rrezikon sigurinë publike dhe ka përsëritur thirrjen për mbylljen e këtij mediumi.

Reagimi i të paditurit ka ardhur pas një kronike të lajmeve qendrore të paditëses, të datës 04.04.2020, ku nga ura në Lumin Ibër në Mitrovicë, gazetarja përhap panik sa i përket gjendjes së sigurisë.

**PROVË 5 : RTK, Lajmet qendrore të orës 19.30, 4 prill 2020, (Burimi: <https://www.youtube.com/watch?v=b552caVwdgc>)**

Sa i përket thirrjes për mbyllje të paditëses, i padituri si tatimpagues i rregullt, aktivist i shoqërisë civile dhe hulumtues profesional, ka shfrytëzuar të drejtën e tij si qytetar që të paraqes qëndrimet e tij për racionalizimin e administratës shtetërore dhe menaxhimin e mirë të parasë publike. Në këtë frymë, i padituri dhe organizata ku angazhohet kanë bërë thirrje të vazhdueshme në zvogëlimin e posteve ministrore, shuarjen e agjencive të pavarura, uljen e numrit të të punësuarve në sektorin publik, etj. Kërkesa për mbyllje të paditëses, si institucion publik, është kërkesë krejt legjitime, për aq kohë sa ky medium vazhdon që të rregullohet me ligje të Kosovës dhe merr financim nga buxheti i shtetit.

Pra, i Padituri nuk ka përhapur fakte të pavërteta dhe nuk ka fyer Paditësit me rastin e postimeve në rrjetin social “Facebook”. Ato që i padituri i ka deklaruar vazhdimisht në qëndrimet e tij publike vërtetohen edhe nga dhjetëra raporte ndërkombëtare të publikuara nga institucione dhe organizata ndërkombëtare. Më poshtë do të paraqesim disa prej tyre:

*Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2021:*

- “Transmetuesi publik, Radio Televizioni i Kosovës (RTK), vazhdon të ekspozohet dhe të jetë nën ndikim të politikës. Dobësitë e RTK -së duhet të adresohen, përfshirë rekrutimet jo-meritore, shpërblime jo transparente,...Kuvendi shkarkoi bordin e RTK-së në korrik 2021, duke përmendur dështimin e bordit të RTK-së për të përmbushur ligjin dhe detyrimet financiare...për refuzim të auditimit nga menaxhmenti i RTK, për mos respektim të procedurave të prokurimit dhe për dështimin e hartimit të një strategjie afatgjatë”

**PROVË 6 : Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2021, fq.31-32, 85 (Burimi: <https://bit.ly/2Z8f1sn>)**

I njëjti konstatim jepet edhe në raportet e Komisionit Evropian për vitin 2018, 2019, 2020.

**PROVË 7: Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2020, fq.32(Burimi: <https://bit.ly/30OjP6D>)**

**PROVË 8:Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2019, fq.26-27 (Burimi: <https://bit.ly/3AË4ugE>)**

**PROVË 9: Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2018, fq.23-24 (Burimi: <https://bit.ly/3G450Nk>)**

Se paditësja është televizion i anshëm politikisht e kanë konstatuar edhe vëzhguesit e zgjedhjeve të Bashkimit Evropian në raportet e tyre monitoruese për zgjedhjet e vitit 2019 dhe 2014. Në vitin 2014 ky mision konstaton se: “Realisht, fushata zgjedhore të gjitha partive parlamentare në media filloi shumë para periudhës zyrtare, kur RTK1 i dha më shumë hapësirë PDK-së 20 ditë para fushatës zgjedhore zyrtare. Komisioni i Pavarur për Media (KPM) ka lëshuar pesë vërejtje për lëshimin e spoteve zgjedhore para fillimit të fushatës zyrtarisht.”

**PROVË 10 : Misioni Vëzhgues i Bashkimit Evropian, raporti preliminar për zgjedhjet parlamentare të 2014, faqe 2 (Burimi: <https://bit.ly/3AX5Ur3>)**

Si dhe në raportin e këtij misioni në vitin 2019 thuhet: “Webfaqja zyrtare e RTK i ka dhënë mbulueshmëri më të madhe dhe më pozitive PDK, duke publikuar më pak lajme për partitë e tjera, me theks të veçantë portretizim më negative ndaj LDK-së”

**PROVË 11 : Misioni Vëzhgues i Bashkimit Evropian, raporti preliminar për zgjedhjet parlamentare të 2019, faqe 9 (Burimi: <https://bit.ly/3DYJUOë>)**

- Për mungesë profesionalizmi, anshmëri politike, keqpërdorime e punësime jo meritore, RTK është paraqitur edhe në raportet e organizatës amerikane IREX, e cila bën monitorimin e lirisë së mediave në mbi 80 vende të botës. Në raportin e IREX për Kosovën në vitin 2019 thuhet: “RTK, si televizion i vetëm publik, vazhdon të ketë presione politike...sindikata e pavarur ka akuzuar disa herë leadershipin e RTK për keq menaxhim të financave dhe punësime familjare”

**PROVË 12: IREX. Media Sustainability Index 2019, fq.57 (Burimi: <https://bit.ly/3jisapx>)**



- “Edhe pse financimi shtetëror ndikon në pavarësinë editoriale të RTK, menaxhmenti dhe bordi kanë preferuar financimin e sigurve nga shteti...disa gazetarë në RTK janë ankuar se paanshmëria e tyre në raportim rrezikohet shpeshherë nga mbikëqyrësit e tyre, për këtë arsye 12 redaktorë të lajmeve protestuan kundër ndërhyrjeve politike në politikën redaktoriale.”

**PROVË 13 : IREX. Media Sustainability Index 2016, fq.75 (Burimi: <https://bit.ly/3B1jZ78>)**

- RTK është kritikuar për keqpërdorime edhe në raportin e performancës të hartuar nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, në të cilin thuhet se “Mekanizmat e brendshëm të RTK nuk kanë parandaluar rrezikun nga mbi-punësimi, hyrja në kontrata të kushtueshme apo obligime pa mbulesë financiare si dhe tejkalimi i shpenzimeve”.

**PROVË 14 : Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Raporti i Auditimit: Dizajni dhe Funksonimi i Sistemit të Menaxhimit të RTK, 2014, faqe 11 (Burimi: <https://bit.ly/3B434R4>)**

- RTK përmes emisioneve të saj ka përhapur gjuhë të urrejtjes, ashtu siç thuhet edhe në këtë publikim shkencor të publikuar më 2021: “Emisioni “Debat” në RTK ka kontribuar në përhapjen e urrejtjes ndaj kundërshtarëve politik (SEENPM, 2021)”

**PROVË 15 : SEENPM, “Gjuha e Urrejtjes në Media në Kosovë”, faqe 8 (Burimi: <https://bit.ly/3jnëm7c>)**

Se RTK është medium i cili nuk bën raportim të drejtë dhe etik, këtë e dëshmojnë edhe raportet vjetore të Komisionit të Pavarur për Media (KPM) të cilat japin shembuj të shumtë të raportimeve jo etike, ku paditësja dënohet me para ose i shqiptohen vërejtje, si për shembull:

“Ankesë nga z.Milaim Sejдини kundër RTK1 për shkelje të Kodit të Etikës – Pas shqyrtimit të rastit ligjor, Komisioni ka vendosur që RTK1 të urdhërohet që në afat prej shtatë (7) ditësh t’i ofrojë Palës Ankuese të drejtën për t’u deklaruar në lidhje me kronikën “Përmirësimet në Arsim”, në mënyrë që Palës t’i sigurohet një prezantim objektiv dhe korrekt, ashtu siç përcaktohet me nenin 6, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, si dhe ka vendosur që RTK1 të sanksionohet me gjobë në vlerën prej dymijë (2,000) euro, në pajtim me nenin 30, paragrafi 1.3, të Ligjit për KPM-në, për shkelje të nenit 6, paragrafi 1 dhe 7, të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03.”

**PROVË 16 : Raporti Vjetor i Punës së KPM për vitin 2019, faqe 10 (Burimi: <https://bit.ly/3lZCtjw>)**

“Rasti i parë është proceduar bazuar në Ankesën e Agjencionit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA) ndaj OSHMA RTK 1. Ankesa i referohet një kronike të transmetuar në edicionin qendror të lajmeve në RTK 1 në të cilën janë trajtuar problemet e sigurisë në Aeroportin e Prishtinës. ASHNA ka bërë ankesë me pretendimin se RTK 1 nuk ka kërkuar përgjigje nga ASHNA lidhur me këtë çështje. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e kronikës dhe ka gjetur se RTK 1 ka bërë shkelje të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për shkelje RTK 1. Edhe pas Njoftimit për shkelje RTK 1 ka dështuar t’i ofrojë ASHNA-së të drejtën e demantit në afat prej shtatë (7) ditësh. Në bazë të Rekomandimit të Zyrës së KPM-së Komisioni i KPM-së mori Vendim që ta dënojë RTK 1 me Vërejtje. Vendimi u është dërguar dy palëve. Rasti është mbyllur.”

**PROVË 17 : Raporti Vjetor i Punës së KPM për vitin 2018, faqe 33-34 (Burimi: <https://bit.ly/3DZOeNw>)**

“RTK 1 - është sanksionuar me gjobë në vlerë prej 1000 € (një mijë euro)”

**PROVË 18 : Raporti Vjetor i Punës së KPM për vitin 2017, faqe 13-14 (Burimi: <https://bit.ly/2Xy4tBP>)**

- I dëmtuar nga një kronikë e tillë jo etike e cila bie ndesh me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale, pjesë e të cilës ka qenë edhe i padituri, kur RTK1 në lajmet qendrore të RTK të datës 24 qershor 2016, kishte paraqitur jo drejtë një postim të të paditurit në Facebook, duke mos më dhënë mundësi të përgjigjet në kronikën e tyre. Zyra Ligjore e KPM, në vendimin e saj të datës 11 korrik 2016, kishte gjetur shkelje të Kodit të Sjelljes për faktin se në kronikën në fjalë ka pasur qëllim të keq, kriticizëm të padrejtë apo sulm ndaj Palës Ankuese. KPM kishte gjetur se RTK1 ka shkelur nenin 6, paragrafin 2 të Kodit të Sjelljes.

**PROVË 19 : KPM, Njoftim për Shkelje, 11 korrik 2016, Ref1607/832/LEG/hzg,numri i ankesës 2016/200**

Për më tepër, vetë drejtori i paditëses, tani e dy vite e gjysmë, mbanë pozitën e tij jashtëligjshëm. Më 24.04.2019, Bordi i RTK përbërë prej 11 vetash kishte zgjedhur me 6 vota si drejtor me mandat tre vjeçar Ngadhnjim Kastratin. Por, sipas nenit 32, paragrafi 3, të Ligjit nr.04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, zgjedhja e drejtorit të përgjithshëm bëhet me 2/3 e votave (apo 7 vota nga 11). Për këtë arsye Shoqata e Televizionit Publik të Kosovës, kishte paraqitur edhe padi në Departamentin e Përgjithshëm Divizioni Civil, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë më 23 maj 2019.

***PROVË 20: Vendimi i Bordit të RTK-së me numër 0046/19 i datës 24.04.2019***

***PROVË 21: Padia e Shoqatës e datës 23.05.20019***

Paditësja është institucion publik i cili nuk respekton as vendimet e institucioneve tjera mbikëqyrëse. Në konkursin e shpallur më 26.10.2020 për Udhëheqës të Shërbimeve të Përbashkëta, RTK kishte zgjedhur Driton Morinën, përkundër asaj se nuk plotësonte asnjëri kriteret e konkursit. Kundër kësaj, Sindikata e Pavarur e RTK kishte dërguar ankesë në Inspektoratin e Punës. Inspektorati kishte konstatuar se RTK kishte shkelur procedurat ligjore me rastin e përzgjedhjes së Udhëheqësit të Shërbimeve të Përbashkëta. Në vendimin e shkallës së parë të Inspektoratit ishte ankuar Driton Morina, por edhe shkalla e dytë kishte kërkuar përsëritjen e konkursit. Përkundër kësaj, RTK ende mbanë në atë pozitë personin e përzgjedhur jashtëligjshëm.

***PROVË 22: Vendimi i shkallës së dytë të Inspektoratit të Punës, datë 05.08.2021***

Paditësja ka ushtruar censure tek gazetarët e saj. Kundër censurës, në vitin 2015 kishin protestuar 12 redaktorë të lajmeve tek paditësja, duke kërkuar largimin e eprorëve Lorik Arifaj dhe Ngadhnjim Kastrati.

***PROVË 23: Telegrafi.com. “Protestojnë 12 redaktorët e RTK-së”, 04/03/2015 (Burimi:***

***<https://telegrafi.com/protестоjne-12-redaktoret-e-rtk-se/>***

Po në vitin 2015, 60 gazetarë dhe redaktorë të RTK-së kishin kundërshtuar largimin nga puna të sindikalistëve të RTK dhe kishin renditur të gjitha shkeljet e vazhdueshme në këtë medium.

**PROVË 24 : “60 redaktorë e gazetarë të RTK-së demantojnë drejtorin Shala”, 12 prill 2015**  
(Burimi: <http://ekonomia-ks.com/?page=1,5,376082>)

Nëntë gazetarë të paditëses kishin protestuar edhe në vitin 2019 kundër avancimeve të padrejta në RTK. Kundër menaxhmentit të RTK ishte reaguar edhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës.

**PROVË 25: RTK KRITIKOHET PËRSËRI PËR PARREGULLËSI, 23.08.2019** (Burimi: <https://kosovotëopointzero.com/rtk-kritikohet-perseri-per-parregullesi/>)

**PROVË 26: Kallxo.com, “Ndëshkimet e Menaxhmentit të RTK-së Shqetësojnë Gazetarët”, 02.09.2019** (Burimi: <https://kallxo.com/gjate/ndeshkimet-e-menaxhmentit-te-rtk-se-shqetesojne-gazetaret-1/>)

Menaxhmenti i paditëses në disa raste ka provuar ndëshkimin dhe përjashtimin nga puna të sindikalistëve, për shkak se këta të fundit kanë ngrit zërin shumë herë për punësimet familjare dhe politike në këtë institucion.

**PROVË 27 : Video 4 në CD: Intervista e kryetarit të Sindikatës së Pavarur të RTK në Interaktiv, 31.03.2021.**

E gjitha kjo që u pasqyrua më sipër, dëshmon se paditësja është institucion i cili në vazhdimësi bën shkelje të Kodit të Etikës, është institucion jotransparent, me punësime jo meritore, për çfarë edhe është raportuar vazhdimisht në raportet e institucioneve kredibile vendore dhe ndërkombëtare.

Një studim reputabil i GJDNJ, ka përmbledhur se “ Në këtë drejtim thelbi dhe objekti i ligjit të fyerjes është subjekt i kufizimeve të ndryshme, me qëllim që të mos cenohet të drejtën e lirisë së shprehjes. Edhe pse gjithkush ka të drejtën personale të reputacionit, ligjet e fyerjes nuk mund të justifikohen nëse qëllimi apo efekti i tyre është të mbrojnë integritet nga dëmi që i bëhet një reputacioni, të cilin nuk e kanë ose nuk e meritojnë.”<sup>2</sup>

Ky nuk është pretendim, mendim apo opinion vetëm i të paditurit, por i institucioneve të tjera vendore ,ndërkombëtare, raporte të BE, vendimeve të organeve si KPM, raportimet nga mediat e shkruara dhe televizive etj. E aq më pak kjo nuk mund të konsiderohet as shpifje dhe as fyerje,

---

<sup>2</sup> Mc Gongagle, Trlach, Një studim I jurisprudencës së GJDNJ, fq 15, par 3.

sepse të gjitha reagimet janë shprehur si rrjedhojë e ngjarjeve të shumta tek paditësja, parregullsitë e panumërta të njohura për publikun e gjerë.

Në rastin konkret, i padituri, nuk është përgjegjës për shpifje apo edhe fyerje të Paditësve, sipas Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes Nr. 02/L-65, si dhe sipas Kushtetutës së Kosovës dhe Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut (më tutje referuar si “KEDNJ) dhe praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut me seli në Strasbourg (më tutje referuar si “GJEDNJ”).

## V. KONKLUDIMI DHE KËRKESA

Bazuar në gjithë sa u tha më sipër, bazuar në provat e bashkangjitura kësaj Përgjigje në Padi, si dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të ligjeve relevante për këtë çështje, të autorizuarit e z.Demi, me respekt i propozojnë kësaj Gjykate të nderuar që të marrë këtë:

### AKTGJYKIM

**REFUZOHET** në tërësi padia dhe kërkesëpadia e Paditëses si e **PABAZUAR**;

**OBLIGOHET** Paditësja që të Paditurit, t’ia kompensojë shpenzimet procedurale sipas nenit 452 të LPK-së.

Përgjigja në Padi e hartuar dhe e paraqitur me respekt nga:

*Shoqëria e Avokatëve  
“Sejdiu & Qerkini” sh.p.k.*

---

Kaltrina Kodraliu

---

Korab R.Sejdiu